# DËSHMI ARKIVI

**A-461469**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përfundon faza e aplikimeve për hetues të BKH-së, 979 kandidatë për 40 pozicione të lira |
| ADRESA | `https://tpz.al/perfundon-faza-e-aplikimeve-per-hetues-te-bkh-se-979-kandidate-per-40-pozicione-te-lira-i333644` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:02:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 19:23:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2d245ad18f22514e168d04efd980b79efd1df533563c7041964a162d5ebf43a5` |
| TEKSTI | `38535fe1a6026a1a4cc3deff57f938610f8bfb0d1ab248a86045d12c0a7dd0ae` |
| PAMJA | `b7b633223fb1638d6c08504838277f6e7179263360754c10642d501afe64c420` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `77a669192e127e3e201b7ebb2d1cc00e7f56bdea9aa7de00e08753e859d84655` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/77a669192e127e3e201b7ebb2d1cc00e7f56bdea9aa7de00e08753e859d84655`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 22 SEPTEMBER 2026, 21:23

# Përfundon faza e aplikimeve për hetues të BKH-së, 979 kandidatë për 40 pozicione të lira

TPZ




Ka përfunduar faza e aplikimeve për 40 pozicione të lira për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ndërsa në përfundim të afatit janë regjistruar gjithsej 979 aplikime.

Përmes një njoftimi BKH thekson se vlerëson interesin e treguar për t'u bërë pjesë e institucionit dhe falënderon të gjithë aplikantët për pjesëmarrjen në procesin e konkurrimit.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit, procesi do të vijojë me verifikimin paraprak të aplikimeve dhe dokumentacionit të paraqitur, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Aplikantët që do të plotësojnë kriteret e përcaktuara do të kualifikohen për fazat e mëtejshme të rekrutimit, të cilat përfshijnë testime dhe vlerësime, si dhe verifikimin e integritetit dhe përmbushjes së kushteve të sigurisë.

BKH bën me dije se kalimi nga njëra fazë në tjetrën do të kryhet vetëm pas përmbushjes së kritereve dhe standardeve të përcaktuara për secilën fazë.

Aplikantët do të njoftohen për rezultatet e verifikimit paraprak, si dhe për datën, orën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të fazave pasuese, përmes kanaleve të komunikimit të përcaktuara në dokumentacionin e procedurës.

Byroja Kombëtare e Hetimit deklaron se synon të zhvillojë një proces rekrutimi transparent, të paanshëm dhe konkurrues, të bazuar në meritë, integritet dhe aftësi profesionale, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët.

Njoftimi i BKH:

Përfundon faza e aplikimeve për pozicionin "Hetues" në Byronë Kombëtare të Hetimit

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) njofton përfundimin e afatit të dorëzimit të aplikimeve në kuadër të procedurës së hapur të rekrutimit për 40 (dyzet) pozicione për hetues në BKH.

Në përfundim të afatit të përcaktuar në njoftimin publik, janë regjistruar gjithsej 979 (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) aplikime për pjesëmarrje në këtë procedurë konkurrimi.

BKH vlerëson interesin e treguar për t'u bërë pjesë e institucionit dhe falenderon të gjithë aplikantët për pjesëmarrjen në këtë proces.

Me përfundimin e fazës së aplikimit, procedura do të vijojë me verifikimin paraprak të aplikimeve dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar, në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të rekrutimit të hetuesve të BKH-së, si dhe në njoftimin për hapjen e procedurës së konkurrimit.

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, aplikantët që plotësojnë kriteret e përcaktuara do të kualifikohen për vijimin e fazave të mëtejshme të procesit të rekrutimit. Këto faza përfshijnë testimet dhe vlerësimet, si dhe procedurat përkatëse të verifikimit të integritetit dhe kushteve të sigurisë, të parashikuara në rregullore. Kalimi nga njëra fazë në tjetrën do të kryhet vetëm pas përmbushjes së kritereve dhe standardeve të përcaktuara për secilën prej tyre.

Aplikantët do të njoftohen për rezultatet e verifikimit paraprak dhe më tej për datën, orën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të fazave pasuese, përmes kanaleve të komunikimit, të cilat janë përcaktuar në dokumentacionin e procedurës.

Byroja Kombëtare e Hetimit mbetet e angazhuar për zhvillimin e një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm, konkurrues dhe të bazuar në meritë, integritet dhe aftësi profesionale, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët.

Shiko të tjera video

AKTUALITET / 22 September 2026, 21:09
Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni

AKTUALITET / 22 September 2026, 20:19
Akuzohet për përkrahje të Ergys Agasit, Vlora Hyseni hyn në territorin shqiptar. I komunikohet në kufi masa arrest shtëpie nga SPAK

AKTUALITET / 22 September 2026, 19:36
BE shpenzon tre herë më shumë për importet nga Kina sesa për eksportet e bllokut

AKTUALITET / 22 September 2026, 19:27
Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri me deklaratë: Kërkohet forcimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e SPAK!

Mbrojtje lirisë së medias nga presionet politike dhe ekonomike

AKTUALITET / 22 September 2026, 19:16

## Zjarr në zonën e Jallisë në Nartë, era e fortë favorizon përhapjen e flakëve pranë banesave

AKTUALITET / 22 September 2026, 19:10

## Sali Berisha u drejtohet strukturave të PD-së: Tani fillon ripërtëritja jonë!

AKTUALITET / 22 September 2026, 18:37

## Zjarri përfshin kodrat e Pojanit, rrezikohet Parku i Apolonisë! Kërkohet ndërhyrje nga ajri me helikopter

AKTUALITET / 22 September 2026, 18:14

## Nga Elbasani në Delvinë, 15 bashki nisin regjistrimin e pasurive, çelet tenderi 3.5 mln euro

AKTUALITET / 22 September 2026, 17:43

## Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve

AKTUALITET / 22 September 2026, 16:44

## Dyshohet se u ndërtua pa leje, sekuestrohet hoteli në Ksamil

AKTUALITET / 22 September 2026, 16:32

## Makina përplasi motorin në zonën e Don Boskos, ndërron jetë 64-vjeçari

AKTUALITET / 22 September 2026, 16:30

## Mesazhi i ambasadës amerikane: Kur SHBA dhe Shqipëria qëndrojnë së

jetë 64-vjeçari

Shqipëria qëndrojnë së bashku, komunitetet tona janë më të sigurta

AKTUALITET / 22 September 2026, 16:26

## "Përdori SHISH për të zhdukur gjurmët", Shehaj: Rama po shkërmoq shtetin shqiptar për t'i shpëtuar drejtësisë

AKTUALITET / 22 September 2026, 16:13

## Sa kushton karikimi i makinës? Kostot për të përshkuar 1,000 km rrugë

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:50

## "Territorialja"/ Belshi miraton kalendarin e konsultimeve, qytetarët do të shprehen për bashkimin me Elbasanin

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:44

## Masa e arrestit ndaj Vlora Hysenit, reagon Edi Rama: Lirim i menjëhershëm nga detyra!

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:42

## Përplasi makinën me murin e banesës dhe dhunoi pronaren/ 54-vjeçari refuzon testin e alkoolit, arrestohet

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:27

## Ndryshon Kodi Doganor/ Më shumë lehtësi për bizneset, kufi për kamatvonesat

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:20

## Aksident i rëndë në Don Bosko, makina përplas motorin, drejtuesi rëndë në

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:07

## Konflikt mes dy nxënësve në Kukës, njëri lëndohet me thikë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.